



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA SHKODËR  
KËSHILLI BASHKIAK**



**V E N D I M**

**Nr. 11, date 30.1.2018**

**PËR DHËNIE PËLQIMI PËR PRANIMIN E DONACIONIT NGA SUBJEKTI “ALB-TIEFBAU” SH.P.K NË CILËSINË E DONATORIT, PËR INVESTIMIN DHE ZBATIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË SHKOLLËS SË MESME TË BASHKUAR “NIKOLLË ZAGORJANI” NË NJËSINË ADMINISTRATIVE VELIPOJË, BASHKIA SHKODËR**

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.1.2018, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të neneve 9 pika 1.2, 23 pika 11, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar,

**V E N D O S I**

1. Miratimin e dhënies së pëlqimit për pranimin e donacionit nga subjekti “Alb-Tiefbau” sh.p.k në cilësinë e donatorit, për investimin dhe zbatimin e rikonstruksionit të shkollës së mesme të bashkuar “Nikollë Zagorjani” në njësinë administrative Velipojë, Bashkia Shkodër.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.1.2018

Shpallur në datën 31.1.2018

**Sekretar i këshillit**

**Suat Hadri**

**KRYETAR**

**Xhemal BUSHATI**